



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.1020/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përbarimore të kreditorit Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës (TEIP) në Kosovë, me seli në Prishtinë, kundër debitorit “Patron” SH.P.K., me NRB:811254792, me seli në Fushë Kosovë, Fshati Miradi, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.S., avokat në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.141/23 të datës 09.06.2023, të Përbaruesit Privat Driton Govori, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 26.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Patron” SH.P.K., dhe Urdhri Përbarimor P.nr.141/23 i datës 09.06.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Driton Govori, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës (TEIP) në Kosovë, ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr.141/23 të datës 09.06.2023, me të cilin e ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarimor – Vendimit të Inspektoratit të Punës me numër 01Nr.09-190-V/2022 të datës 23.11.2022, me të cilin ka urdhëruar debitorin që pas pranimit të këtij urdhri t’i paguaj kreditorit në emër të masës ndëshkimore shumë në vlerë prej 4,800.00 € dhe shpenzimet e procedurës përbarimore, në të kundërtën përbarimi të realizohet përmes ndalimit të mjeteve në para të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe pagesa të bëhet në llogarinë e veçantë të përbaruesit privat.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se urdhri përbarimor i lejuar nga përbaruesi privat nuk është i bazuar dhe nuk është i mbështetur në

prova. Ka theksuar se, vendimi në bazë të së cilit është lejuar përmbartimi është i palejueshëm sepse nuk janë plotësuar kushtet ligjore në bazë të LPP-së, pasi që nuk ka titull ekzekutiv ose vendimi nuk përmban tipare të përmbartueshmërisë. Tutje ka theksuar se, Inspektorati i Punës nuk ka trajtuar në mënyrë objektive pretendimet ankimore të ankuesit dhe e njëjta ankesë i është refuzuar nga organi i shkallës së dytë. Gjithashtu ka theksuar se debitori ka iniciuar konfliktin administrativ pranë Gjykatës Komerciale për kontestimin e vendimit mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim. Gjykatës i ka propozuar që të aprovoj prapësimin e debitorit dhe të anuloj Urdhrin Përmbartimor P.nr.141/2023 të datës 09.06.2023.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit në lidhje me bazën juridike për përmbartim dhe ligjshmërinë e procedurës përmbartimore, pasi që urdhri përmbartimor është nxjerrë në pajtim me dispozitat ligjore të LPP-së dhe janë plotësuar kushtet për përmbartim. Tutje ka theksuar se, vendimet e TEIP janë të ekzekutueshme dhe ushtrimi i padisë në konflikt administrative nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj prapësimin e debitorit dhe të mbetet në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.141/2023 i datës 09.06.2023.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke i'u referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të shfuqizohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*.

Sipas nenit 22 par.1 të LPP-së, janë përcaktuar dokumentet përmbartuese ndërsa me par.1 nën par. 1.2 të këtij neni, si dokument përmbartues përcaktohet: *“vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia)”*, ndërsa me nenin 36 par.1 të LPP-së, përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbartim, organit përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri”*.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Vendimi i Inspektoratit të Punës me numër 01Nr.09-190-V/2022 i datës 23.11.2022, në bazë të së cilit është mbështetur propozimi për përmbarim është bashkëngjitur në kopje, ndërsa në shkresat e lëndës nuk është deponuar origjinali apo kopja e vërtetuar tek organi kompetent, e rrjedhimisht propozimi për përmbarim është paraqitur në kundërshtim me neni 38 par.1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm..”*

Sipas nenit 43, par.4 të LPP-së përcaktohet se: *“...Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrit të përmbarueshmërisë së nxjerrë nga përmbaruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbaruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarim nga përmbaruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”.*

Andaj nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarimit P.nr.141/23 i datës 09.06.2023, është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase propozimit për përmbarim nuk i është bashkëngjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e dokumentit përmbarimor dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat në këtë fazë të procedurës nuk mund të evitohen nga gjykata, ngase në fazën e mjetit juridik, gjykata kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit.

Meqenëse në rastin konkret, sipas vlerësimit të gjykatës nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbarim, ndërsa organi përmbarues - përmbaruesi privat, nuk ka vepruar konform nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”*, gjykata shfuqizoi urdhrin përmbarimor dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata në kuptim të nenit 43, 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1020/23, datë 26.09.2023

Gjyqtarja  
Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.